



Nr. 2386/11 prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**SENATI AKADEMIK**

Elbasan, më 09/11/2021

**VENDIM**

Nr. 28/11 datë 09.11.2021

**"PËR**

**RIRORGANIZIMIN E DY NJËSIVE BAZË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË  
EDUKIMIT"**

Në mbështetje të nenit 30 pika 6, nenit 38 gërma "ë" të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 9 gërma "k" të Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", me propozim të Dekanatis të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, pas miratimit të Bordit të Administrimit me Vendim nr.46 datë 02.11.2021, Senati Akademik

**V E N D O S I:**

1. Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Shkencave Sociale" dhe njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Edukimit Qytetar" riorganizohen në një njësi bazë të emërtuar "Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar".
2. Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit mbyllet njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Shkencave Sociale".
3. Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit mbyllet njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Edukimit Qytetar".
4. Njësia bazë e re e emërtuar "Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar" do të jetë përgjegjëse për programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Edukimit Qytetar.
5. Dokumentacioni i Departamentit të Edukimit Qytetar dhe Departamentit të Shkencave Sociale do të administrohen nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar.
6. Ngarkohet Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim t'i njoftohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Prof.Dr. Skender TOPI**

